

20221502011

LIGJ PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT PËR TREGTI

Neni 1

Në Ligjin e Tregtisë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 16/2004, 128/2006, 63/2007, 88/2008, 159/2008, 20/2009, 99/2009, 105/2009, 115 /10, 158/10, 36/11, 53/11, 148/13, 164/13, 97/15, 129/15, 53/16, 120/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" numër 77/21, 215/21 dhe 295/21), në nenin 22, paragrafi (1) ndryshohet si vijon:

“Shitoret, shtëpitë e mallrave, qendrat tregtare (mollet), vetshërbimet, magazinat, depot dhe hapësirat afariste, tregjet e gjelbra, tregjet speciale me shumicë dhe pakicë, auto-placet dhe stacionet e benzinës, të përcaktuara në nenet 10, 12, 13, 15 dhe 16 të këtij ligji, për kryerjen e tregtisë me shumicë dhe pakicë, doemos duhet t’i plotësojnë kushtet minimale teknike, si dhe kushtet e tjera të përcaktuara me ligj, varësisht nga lloji dhe mënyra e kryerjes së tregtisë“.

Neni 2

Në nenin 25, paragrafi (4) fjala “ligj” zëvendësohet me fjalët “neni 2 i Ligjit të Festave të Republikës së Maqedonisë”.

Në paragrafin (5), pika 1) ndryshohet dhe thotë:

"në shitore, kioskë dhe stenda në vendet turistike të përcaktuara me Ligjin e Veprimtarisë Turistike;“.

Pika 2) ndryshohet dhe thotë:

“në stacionet e benzinës dhe në shitoret e stacioneve të benzinës brenda të cilave kryhet tregtia me pakicë;”.

Pika 3) ndryshohet dhe thotë:

“në qendrat tregtare (mollet) që i plotësojnë kushtet minimale teknike në pajtim me rregullin nga neni 22, paragrafi (2) të këtij ligji;“.

Pas pikës 3) shtohet pikë e re 4, dhe thotë:

"4) në shitoret e lira doganore;

Pikat 4) dhe 5) bëhen pika 5) dhe 6).

Në pikën 6) pas fjalës "tregje" shtohen fjalët "dhe në tregjet e luleve".

Në paragrafin (8), fjalët “kopshte të fëmijëve” zëvendësohen me fjalët “Fondi i Zhvillimit dhe i Kapitalit Njerësor”.

Paragrafi (9) ndryshohet dhe thotë:

“Për shitoret në stacionet e benzinës nga paragrafi (5) pika 2) të këtij neni, të ardhura të realizuara konsiderohen të ardhurat e përgjithshme të realizuara nga tregtia me pakicë, pa të ardhurat e realizuara nga shitja e karburanteve motorike (derivative të naftës)”.

Në paragrafin (13), nënparagrafi 1), ndryshohet dhe thotë:

"- tregtarët nga paragrafi (5), pika 1) të këtij neni mund të punojnë nga ora 8:00 deri në ora 22:00, ”

Alineja 2 ndryshohet si vijon:

“- tregtarët nga paragrafi (5), pika 2) dhe 4) të këtij neni mund të punojnë nga ora 00:00 deri në ora 24:00,

Në nënparagrafin 3) lidhëza "dhe" zëvendësohet me presje dhe shtohet nënparagrafi i ri 4 dhe thotë:

“- Tregtarët nga paragrafi (5), pika 5) e këtij neni mund të punojnë në periudhë prej tetë orësh, që do ta përcaktojnë vetë në pajtim me paragrafin (3) të këtij neni dhe”.

Neni 3

Në nenin 49 paragrafi 1 fjalët "neni 55, paragrafi (1) nënparagrafët 1, 2, 3, 5, 6 dhe 8" zëvendësohen me fjalët "neni 55, paragrafi (1), pikat 1), 2), 3), 5), 6) dhe 9)".

Neni 4

Në nenin 50, paragrafi (2) fjalët: "Komisioni shtetëror për vendimmarje në procedurë administrative dhe procedurë të marrëdhënies së punës në shkallë të dytë" zëvendësohen me fjalët: "organi kompetent për vendimmarrje në shkallë të dytë në pajtim me ligjin".

Neni 5

Neni 55-a ndryshohet dhe thotë:

"Gjobë në shumë prej 500 deri në 1.000 euro në kundërvlerë në denarë për tregtarët mikro dhe të vegjël dhe nga 1.000 deri në 2.000 euro në kundërvlerë në denarë për tregtarët e mesëm dhe të mëdhenj do t'i shqiptohet për kundërvajtje tregtarit nëse vepron në kundërshtim me dispozitat e nenit 30-a të këtij ligji.

Gjobë në shumë prej 50 euro në kundërvlerë në denarë për personin e punësuar do t'i shqiptohet për kundërvajtje nëse vepron në kundërshtim me dispozitat e nenit 30-b të këtij ligji.

Gjobë në shumë prej 25 deri në 50 euro në kundërvlerë në denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje tregtarit individual për veprimet nga neni 55 paragrafi 1 i këtij ligji.

Për kundërvajtjet nga paragrafi (3) i këtij neni, inspektori shtetëror i tregut do t'i lëshojë urdhërpagesë për kundërvajtje tregtarit individual.

Nëse kryesi i kundërvajtjes nuk e paguan gjobën nga urdhërpagesa për kundërvajtje, inspektori shtetëror i tregut paraqet kërkesë për ngritjen e procedurës kundërvajtëse në Komisionin për Kundërvajtje".

Neni 6

Në Ligjin për tregti ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" numër 215/21), neni 3 me të cilin shtohet nen i ri 55-a fshihet.

Neni 7

Në nenin 58, paragrafi (1) në pikën 6) lidhëza "dhe" zëvendësohet me presje.

Në pikën 7) pika në fund të fjalisë zëvendësohet me lidhëzën "dhe" dhe shtohet pikë e re 8) dhe thotë:

"8) nëse vepron në kundërshtim me dispozitat e nenit 50, paragrafi (1), të këtij ligji."

Në paragrafët (3) dhe (8) fjalët "pikat 1, 2, 3, 4 dhe 5" zëvendësohen me fjalët: "pikat 1, 2, 3, 4, 5 dhe 8".

Në paragrafin (13) fjalët: "pikat 2 dhe 4" zëvendësohen me fjalët: "pikat 2, 4 dhe 8".

Neni 8

Ky ligj hyn në fuqi ditën e tetë nga dita e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut.